



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-10158/26 datë: 20.05.2026



Npi – 01/101 datë: 29.05.2026

Duke u bazuar në nenin 44 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes e mbajtur më 29.05.2026, është nxjerrë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I Mbledhjes së -IV- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes,
e mbajtur më datën 29.05.2026 (e premte), në ora 10:00AM, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adelina Shabani, z.Asllan Beqaj, znj.Albana Ramadani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari, z.Adnan Ademi; DBF, z.Besnik Ahmeti, DPP, z.Valon Januzi, DZHE, z.Grejtalb Emini; zyrtarë i IT-së z.Shpëtim Gashi; zyrtarë z.Besart Aliu; zyrtarë z.Reshat Gashi; zyrtare znj.Vlora Hyseni; përfaqësues nga OSBE z.Mefail Mustafa; Praktikantët, z.Albion Shabani, znj.Hava Llugaxhija, znj.Tahire Selmani. Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin dhe propozoi këtë rend dite.

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur më: 30.04.2026, 15.05.2026,
2. Pyetje-Përgjigje,
3. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029 (për diskutim publik),
4. Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2025 në vitin 2026,
5. Raporti i Auditimit për PVF të vitit 2025 për Komunën e Shtimes nga ZKA,
6. Shqyrtimi i kërkesës për ndërhyrje nga KEDS-i, në rrjetin e energjisë elektrike në fshatin Pjetërshticë.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Përshëndetje. Për të gjithë konstatoj kuorumin prej 20 anëtarve prezent në mbledhje. Para se me vazhdu mbledhjen ja kaloj fjalën znj.Albana Potvorica-Hoxha.
znj.Albana Potvorica - Hoxha: Përshëndetje. Para se me fillu mbledhjen si shenjë respekti dhe nderi ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje për gazetarin e kuvendit tonë, profesorin, poetin dhe aktivistin tonë të ndjerin z.Muhamet Hoxha i cili u nda nga jeta ditë më parë duke na lënë të gjithëve të pikëlluar. z.Muhamet hoxha do të kujtohet gjithmonë për kontributin e tij të çmuar në gazetari, arsim, kulturë dhe jetën publike të qytetit tonë. Në këto momente dhimbjeje, shprehim respektin dhe mirënjohje për jetën dhe vepren e tij, ndërsa familjes u përcjellim ngushëllimet më të sinqerta ju ftojmë ta mbajmë një minut heshtje. Nderime!

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit, vazhdojmë me rendin e ditës hapi diskutimin.

z.Demokrat Mujota: Përshëndetje. Ne si grup parlamentar propozojmë që pika e 4 Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2025 në vitin 2026, të shtyhet për mbledhjen e radhës sepse materiali është ardhë shumë me vonë, dhe nuk kemi pas mundësi me e shqyrtuar gjithë atë material.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Deshta me ta dhënë një sygjërim i nderuari Kryesues, që fjala i jepet gjithmonë grupit më të madhë të asambles e që në këtë rast është LVV-ja, e atë pak për shtimin ose heqjen e ndonjë pike të rendit të ditës. Ne si grup në lidhje me shtimin e pikës së rendit të ditës, duke pas parasysh se KPF-ja ka mbetë i mangët me minus një anëtarë të Kuvendit, propozojmë që të shtohet kjo pikë e rendit të ditës në pika të tjera të cilat i keni sjellë ju si Kryesues i këtij Kuvendi.

z.Shefqet Krasniqi: Përshëndetje. Ne si grup i LDK-së i shprehim ngushëllime familjes. Jemi dakord me kërkesën e Besnikut që të plotësohet KPF-ja.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Unë do të mundohem me i përmbledhë të gjitha kërkesat e anëtarëve të cilat i propozuan. Pra është një kërkesë që e propozuan të largohet pika e 4 të rendit të ditës, pastaj e kemi edhe kërkesën për plotësimin e KPF-së.

z.Haqif Arifi: Përshëndetje. Sa i përket bartjes kjo në aspektin teknik është procedurë ligjore dhe e lejuar për ligjin për menagjimin e financave dhe për ligjin për ndarjen buxhetore. Mirpo edhe unë e shoh të arsyeshme që kjo pikë e rendit të ditës për shumë arsye është mirë me u shty sepse këtu kemi bejmë për pages për punë të krye mirpo të cilat nuk janë kry me kohë prandaj edhe unë mendoj që kjo pikë duhet të shtyhet sepse edhe materjali ka ardh me vonë.

z.Demokrat Mujota: Ne rekomandojmë me shty këtë pikë të rendit të ditës që të kemi kohë me analizu pak më shumë.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Nëse ju pretendoni për me shty këtë pikë, atëherë ju merrni përgjegjësi para qytetarëve, për shkak se pjesa më e madhe e të hyrave të barturave është 80 mijë euro kanë me shku te shpenzimet komunale, dhe njerë apo masnjerë ju ndërpritet rryma QKMF-së edhe Çerdhës ju jeni përgjegjës. Besoj që kjo pjesë e materialit ka qenë dy faqe, dhe mendoj se për 5 ditë e kishit përfunduar.

z.Haqif Arifi: Këtu nuk po e shoh që është duke u bërë bartja për investime të reja, bartja është duke u kërkuar me u bërë pagesa për punë të kryera. Pse nuk janë bërë këto pagesa me kohë? Nuk mundet me marrë barrën Kuvendi, kjo i takon drejtorive përkatëse.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Nuk është çështje e vonësive në pagesa. Ju e keni parë se përmbaruesi i ka marrë mjetet e dedikuara për projektet kapitale. Për sa u përket shpenzimeve komunale, nuk është se faturat janë dorëzuar me vonë, ato janë dorëzuar me kohë dhe pagesat janë kryer. Mirëpo, jemi në fund të muajit të pestë dhe na duhen mjete për të përmbushur obligimet që do të vijnë në vazhdim. Kjo nuk ka të bëjë me projekte të reja. Përmbaruesi i ka marrë mjetet dhe, kur ke obligime nga të hyrat e bartura, duhet të përmbushen obligimet kontraktuale. Edhe QKMF-ja dhe çerdhja kanë nevojë për buxhet shtesë, nuk bëhet fjalë për vonë në pagesa.

z.Haqif Arifi: Po i përmend 5 muaj, po i harron edhe 12 muaj. Nuk po flasim për investime të reja, por po flasim për punë të kryera dhe të pa paguara. Nëse e presim përmbaruesin kurrë nuk ndalet.

z.Demokrat Mujota: Që 7 vite është LVV në pushtet. Shikoni raportin e Auditorit për rekomandime iu ka dhënë. Ju fajtor nuk mundeni me gjetë, mos gënjeni që ka me u ndal rryma. Presionin mundesh me ia shitë dikujt tjetër.

z.Muhamet Ademaj: Sa i përket rendit të ditës unë nuk pajtohem që pika e 4 e rendit të ditës të largohet, nuk është mirë me i lënë faturat pa pagu. Nëse shtyhet për një muaj janë obligimet e Komunës. Nëse lihet çerdhja pa paguar, për çka jemi ne si kuvendar këtu dhe pse duhet me votu kundër kësaj pike të rendit të ditës.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Mendova se sot mbledhja do të përfundonte shumë shpejt, por nuk e kisha besuar se do të ndaleshim kaq gjatë te kjo pikë e rendit të ditës. E di se mund të ketë reagime ndaj fjalëve të mia, por a jemi duke bërë politikë? Po, jemi duke bërë politikë. A kemi kohë për politikë? Po, sepse janë edhe zgjedhjet. Megjithatë, pajtohem plotësisht me diskutimin që bëri drejtori lidhur me pasojat që mund të ketë mos realizimi i kësaj bartjeje të të hyrave. Ju keni përgjegjësi, ndërsa ne kemi obligim që kjo bartje të bëhet nga viti në vit. Nëse nuk është

bërë më herët, u dha një arsyetim shumë i qartë se përse nuk ka ndodhur kjo. Prandaj, konsideroj se duhet të veprojmë në përputhje me obligimet tona dhe të sigurojmë realizimin e kësaj bartjeje. Është shumë më e rëndësishme që kjo bartje të miratohet sot sesa të vazhdojmë me diskutime të stërzgjatura. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet se KPF-ja ka marrë një rekomandim paraprak lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhe ka rekomanduar që ajo të procedohet për shqyrtim dhe vendimmarrje në kuadër të diskutimit në Kuvend.

z.Shefqet Krasniqi: Unë e kam thënë dhe do ta them përsëri se çdo çështje që prek paranë e qytetarit dhe është në të mirën e qytetarëve, ne do ta mbështesim dhe do ta tejkalojmë çdo dallim. Edhe këtë propozim e kam votuar. E kam votuar duke shfrytëzuar mundësinë për diskutim dhe duke paraqitur vërejtjet që kemi identifikuar. Nëse konsideroni se është vonë për ta shtyrë këtë çështje deri në seancën e radhës së muajit të ardhshëm, ne mund të caktojmë edhe një seancë të jashtëzakonshme, të dedikuar vetëm për këtë pikë të rendit të ditës. Në këtë mënyrë, do të kemi mundësi ta shqyrtojmë më hollësisht dhe të marrim një vendim sa më të përgjegjshëm.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Këtu po vërehet qartë se inatet po e humbin arsyen e diskutimeve. Nuk ka ndonjë arsye të madhe që kjo pikë të stërzgjetet. Nga materiali që ka ardhur, nuk po shoh diçka që është e pa menaxhuar ose jo në përputhje me ligjin. Shumica e pikave që do të barten kanë të bëjnë me arsimin, shërbimet sociale, menaxhimin e katastrofave dhe shëndetësinë. Diskutime mund të bëjmë, por jo ta zvarrisim këtë pikë. Ne, si anëtarë, mund të bëjmë pyetje, të propozojmë përmirësime dhe të japim rekomandime, por jo ta pengojmë procesin.

z.Shefqet Krasniqi: Po e citoj pjesën që ka të bëjë me menaxhimin e katastrofave dhe vërshimeve. Kjo pikë më shumë i takon nivelit qendror, përkatësisht ministrisë.

z.Faik Ramadani: Përshëndetje. Po mundohem ta kuptoj rëndësinë e kësaj pike të rendit të ditës. Pajtohem që t'i tejkalojmë të gjitha çështjet, por pse duhet të vijmë gjithmonë nën presion për të punuar dhe çdo herë të na thuhet, ose votohet sot, ose hiqet fare? Më pëlqen propozimi që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme brenda 7 ose 10 ditëve. Nëse kjo nuk mund të realizohet, atëherë propozoj që të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal t'i dërgojmë në shtëpi, sepse ky legjislativ i kushton komunës rreth 800 mijë deri në 1 milion euro për katër vjet. Po të ishin investuar këto mjete diku tjetër, besoj se qyteti i Shtimes do të kishte përfutur më shumë sesa nga tregimet që po i dëgjojmë këtu. Nuk kam ardhur këtu për politikë; i respektoj të gjitha partitë. Unë jam përfaqësues i qytetarëve të Komunës së Shtimes.

z.Fatlinda Rrafshi: Përshëndetje. Më vjen shumë mirë që u hap tema e diskutimit për çerdhen, mirëpo ekzekutivi po harron se në çerdhe jemi ende me ushtrues detyre. Po ashtu, Raporti i Auditimit për QKMF-në ka evidentuar se janë duke u mbajtur 10 pozita pa drejtësisht. Këto janë të dhënat që Auditori i ka paraqitur në raportin e fundit.

z.Demokrat Mujota: Këta po mundohen me kriju një situatë që me lënë fajtor.

z.Besnik Seferi: Na u drejtuat me termin "marre". A nuk duhet t'ju vijë juve marre për shumë bllokada që i keni bërë dhe vazhdoni t'i bëni? Për katër vite sa ka qenë LVV-ja në pushtet, ju keni qenë ata që i keni bllokuar proceset që kanë qenë në të mirë të qytetarëve. Siç u ritheksua edhe më herët, ky buxhet dhe kjo bartje e të hyrave nuk janë vetëm për të mirën tonë, por për të mirën e të gjithë qytetarëve pa dallim.

z.Shefqet Krasniqi: Termi "marre" lidhet me fjalën tuaj, z. Seferi, dhe do të ndalem vetëm te një pikë, ajo e mosvotimit. Ju thatë se LDK-ja dhe PDK-ja në seancën e fundit të vitit 2025 nuk e kanë votuar buxhetin. Sa di unë, buxheti është dashur të menaxhohej nga legjislatura e vitit 2026 dhe është lënë që ta menaxhojë kjo legjislaturë. Do të ishte e ndershme, z. Seferi, të thoshit se kjo legjislaturë për vitin 2026 e ka votuar për herë të parë buxhetin e Komunës së Shtimes me 100%, pra me 21 vota, falë edhe angazhimit të LDK-së. Këtë është dashur ta përmendnit gjithashtu. Ne kemi vërejtje, por duhet të jemi transparentë, këto janë vërejtjet dhe këto janë të mirat. Pra, kjo legjislaturë, me një marrëveshje politike të të gjithëve, e ka votuar për herë të parë buxhetin në vitin 2026.

z.Bajram Hajrizi: Desha të bëj një replikë ndaj z. Besnik Seferi. Në mbledhjen e fundit të jashtëzakonshme ai tha se PDK-ja dhe LDK-ja i kanë kapur bordet dhe se duhet të na vijë marre. Mirëpo, a ka marre ai që nuk e ka sjellë raportin e komisionit të KRM "Pastërtia" për vitin e

kaluar? Ai e ka zvarritur një mbledhje dhe sot vjen e thotë “marre”. Për këtë paska qenë mirë të jesh në bord, ndërsa për të tjerët paska qenë keq të jenë pjesë e bordit.

z.Muhamet Ademaj: Edhe unë kam një kërkesë për kandidatët e LDK-së dhe PDK-së që të mos i bllokojnë shërbimet komunale. Është mirë të kemi parasysh se këto janë shërbime që u ofrohen qytetarëve të Shtimes dhe institucioneve komunale. Edhe nëse shtyhen për një muaj, nuk do të ketë ndryshime. Megjithatë, shpresoj në mirëkuptimin e të gjithëve dhe që kjo pikë të mos largohet nga rendi i ditës.

z.Besnik Seferi: Nuk e pata ndërmend të flas më, sepse tashmë dihet se çfarë vendimi do të merret. Megjithatë, dua të potencoj se kolegu më akuzoi për një raport që, sipas tij, nuk e kemi sjellë. Kjo nuk është e vërtetë dhe nëse e kërkon sot, jam i gatshëm t’ia sjell.

z.Shefqet Krasniqi: Në emër të LDK-së ju garantoj që asnjë punë dhe asnjë projekt nuk do të bllokohet.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Në emrin tim, të Kryetarit Aliu dhe të Ekzekutivit, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Hoxha. Rendi i ditës përmban 5 apo 6 pika. Komitetet janë në ndihmë të Kuvendit dhe duhet të përmbushin rolin e tyre. Përpara kam rekomandimin nga mbledhja e parë e KPF-së lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, e cila ka marrë 3 vota “Për” dhe 3 vota “Abstënim”, duke i rekomanduar Kuvendit që kjo pikë të shqyrtohet edhe sot. Nëse në Komitet merrni vendim t’ia rekomandoni Kuvendit kalimin e një pike të rendit të ditës, e më pas vini këtu pas dy ditësh dhe votoni kundër saj, do të ishte mirë të orientoheni dhe të dini saktësisht se çfarë po votoni. Sa i përket pikës së rendit të ditës për propozim-vendimin mbi ndarjen e të hyrave, kjo është një çështje ligjore. Dëgjova dikë të thotë se nuk është shumë urgjente, por kjo është në fakt shumë urgjente, sepse bartja e të hyrave duhet të ndodhë. Dua të ndërlihem edhe me dy çështje të tjera. U tha se buxhetin e kanë votuar PDK-ja dhe LDK-ja. Në fakt, buxheti është bllokuar nga PDK-ja dhe LDK-ja. Ekziston video live ku shihet qartë se LVV-ja e ka sjellë buxhetin në votim, ndërsa asamblistët janë detyruar të mos e votojnë atë. Ky është realiteti.

z.Shefqet Krasniqi: E thashë edhe në fillim se me votën time ka kaluar në KPF kjo pikë, por shikoni në procesverbal se çfarë kam thënë të diskutohet dhe duhet të jem shumë i qartë. Ju thatë se nuk jam në gjendje t’i lexoj dy faqe Nënkryetar, për të lexuar, lexoj më mirë se Resul Sinani dhe Mustaf Muqaj, por nuk është çështja vetëm të lexohet. Kur lexohet diçka, duhet të zbërthehet dhe të nxjerrim diçka nga ajo. Kam një kërkesë personale për ju që ta tërhiqni fjalën për atë që thatë, sepse Besniku propozoi që grupi i Lëvizjes Vetëvendosje në KPF të zëvendësohet me një anëtar shtesë që i takon, dhe unë thashë “po”. Askush nuk e diskutoi këtë çështje, andaj ju lutem ta tërhiqni atë fjalë.

z.Faruk Beqa: Përshëndetje. Unë po propozoj 5 minuta pauzë, që të takohen me shefat e grupeve të partive në asamble dhe të shqyrtojmë këtë çështje nese jeni dakord.

z.Haqif Arifi: Unë nuk desha të marr fjalën, por më nxiti diskutimi i Nënkryetarit. Nënkryetar, unë thashë se bartja e të hyrave është procedurë ligjore e lejuar nga Ligji për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë, si dhe nga Ligji për Ndarjet Buxhetore. Kjo tregon edhe arsye jo të mira, si realizim jo të mirë të projekteve kapitale, obligime të papaguara, mungesë të planifikimit financiar dhe ngarkim të buxhetit vijues. Është mirë sepse ne jemi të gjithë shqiptarë dhe jemi të besueshëm, por këto ligjërata që po mundoheni t’i jepni, jo vetëm sot por edhe herëve të tjera, ne i marrim për xhami.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po shkojmë në pauzë në ora 11:14. Vazhdojmë pas pauzës në ora 11:26. Kemi dy propozime, njëri për shtyrjen e pikës së rendit të ditës dhe tjetri si propozim shtesë. Mirëpo, sipas Rregullores së Kuvendit dhe Komiteteve, fillimisht do ta hedh në votim rendin e ditës ashtu siç është propozuar. Nëse kalon mirë, nëse nuk kalon, do të shkojmë me propozimet e anëtarëve të Kuvendit.

z.Shefqet Krasniqi: Po e them kështu: jemi për ta shtyrë këtë pikë, por megjithatë sot mund të caktojmë një datë brenda 5 apo 7 ditëve, kur të doni ju, kolegë nga Lëvizja Vetëvendosje. E thërrasim një seancë dhe diskutojmë vetëm për atë pikë.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim rendin e ditës ashtu siç ka ardhur. Konstatoj kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 0 vota “Për” dhe 11 vota “Kundër” dhe 9 vota “Abstenim” nuk miratoi rendin e ditës ashtu siç ka ardhur.**

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Po e hedhë në votim rendin e ditës, me propozimet e bëra.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes me 11 vota “Për” dhe 0 vota “Kundër” dhe 9 vota “Abstenim” dhe miratoi rendin e ditës me këto ndryshime:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur më: 30.04.2026, 15.05.2026,
2. Pyetje-Përgjigje,
3. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029 (për diskutim publik),
4. Raporti i Auditimit për PVF të vitit 2025 për Komunën e Shtimes nga ZKA,
5. Shqyrtimi i kërkesës për ndërhyrje nga KEDS-i, në rrjetin e energjisë elektrike në fshatin Pjetërshticë,
6. **Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares së KPF-së znj.Yllkë Fejzullahu, me një anëtare të re (Pikë shtesë).**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt - Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur më: 30.04.2026, 15.05.2026

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Konstatoj kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 19 “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe 1 të votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt - Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 30.04.2026, dhe me 15.05.2026**

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin. Fjalën ia dha znj. Erza Salija.

znj.ErzaSalija:Përshëndetje. Unë kam një pyetje për ekzekutivin. Pyetja ime ka të bëjë më saktësisht me lagjen Bytyqi, e cila gjendet në rrugën Qamëria. Është shqetësuese fakti se kjo lagje end epërballet me mungesë të kanalizimit, dhe si pasojë e kësaj mungese ata detyrohen të përdorin gr opa septike, të cilat jo vetëm janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, por edhe për ambientin. Py etja ime është: kur do ta trajtojë Komuna këtë problem bazik për qytetarët, edhe pse kjo zonë deri më tani është lënë pas dore?

z.Muhamet Ademaj: Pyetje për DPUKGJ: Sa leje ndërtimi keni lëshuar gjatë vitit 2025?

z.Faik Ramadani: Ndoshta është mirë të hiqet kjo pikë pyetje-përgjigje, sepse zakonisht kemi pasur pyetje, por përgjigje të sinqerta dhe të arsyeshme deri më sot unë si asambleist nuk kam marrë. Ndoshta kam marrë përgjigje, por nuk kanë qenë të arsyeshme. Tash kemi frikë nëse do të vazhdojmë me kërkesën se si jemi të detyruar, apo do të ndryshojmë diçka në atë qasje, apo do të gjykohe mi. Kërkoj të vazhdojmë me kryerjen e detyrave tona që na takojnë, apo do të vazhdojmë ndryshe. Jam kundër asaj që kemi përgjegjësi për gjëra që nuk i bëjmë. Kjo lidhet me pikën që nuk e aprovova vendimin. Unë flas personalisht, nuk kam asnjë interesim për këtë pikë sepse i kemi thënë të gjitha ato që duhet t'u thuhet një asambleist apo përgjegjësi që është i detyruar para qytetarëve. Nuk di më shumë kërkesa, dhe më në mënyrë të sinqertë, si asambleist jemi munduar të ndajmë se cilat janë urgjente dhe cilat jo. Kam kërkuar pse u hoq rruga “Rrezja”, kam bërë pyetje edhe me shkrim, por nuk kam arritur të marr përgjigje. Si mund të arsyetohemi para qytetarëve kur nuk marrim përgjigje? Jam shumë i prekur sepse dihet që kjo është detyrë e ekzekutivit, ne si legjislativ nuk mundemi të japim përgjigje për naivitetin e pyetjeve. Kërkesat e mia nuk mund t'i ndaloj sepse ju kemi premtuar qytetarëve. Kam mbetur pa përgjigje për punën e ankesës që kanë bërë bizneset e Shtimes, do ta lë për një trajtim të veçantë apo mundem ta trajtoj edhe këtu, por e lë një rrugëzgjidhje sepse është sezoni dhe lejohet puna, por unë nuk mundem të shtyj. Nëse i mbaj këto nënshkrime të bizneseve në përgjegjësin tim, nuk mundem të dal para tyre e të them se nuk do të merrem me këtë punë. Edhe nëse është vetëm një kërkesë e

një biznesi, ndjej përgjegjësi, por ne si Kuvend duhet ta trajtojmë. Kam pasur një kërkesë për shpronësim për lagjen "Rrusta", ku nevojitet shtrirja e rrjetit të kanalizimit në rrugën "Anton Çeta", kërkesë nga z. Hyzri Rrusta. Nuk kam marrë përgjigje dhe nuk kam parë as në kornizën afatmesme buxhetore. Kam një kërkesë nga fabrika "Mendi", kërkojnë qasje në rrugën e "Tranzitit" për shtrimin e rrjetit të kanalizimit, kërkesa është bërë nga z.Fadil Behluli pronari i fabrikës? Kam edhe një kërkesë nga lagja Dugolli, ku janë dëmtuar mbrojtëset e rrugës shumë, dhe është rrezik për këmbësorët. Kërkesën e ka bërë z.Agim Dugolli për vendosjen e mburojave aty?

z.Besnik Seferi: Me shqetësimin e Faikut isha i lidhur edhe unë, sepse përgjigjet duhet të jepen, dhe ka përgjegjësi edhe ekzekutivi. Nëse nuk janë dhënë, kërkoj që të gjitha përgjigjet që bëhen nga ky Kuvend të jepen, nëse jo drejtpërdrejt në formë të shkruar. Unë do të lidh pyetjen me çështjen e kanalizimit në rrugën "Çamëria", jo vetëm për lagjen Bytyqi, por edhe në lagjen Rashiti, Ramushi, Bajrami, Jakupi dhe Asllani. Meqenëse me drejtorët e kam diskutuar si shqetësim, dhe si të tillë e kemi lënë bashkarisht, pse jo edhe ekzekutivi të dalë në teren dhe të shoh shqetësimin dhe ta vendos në kuadër të projekteve të ardhshme. Ku jemi me proces dua të pyes drejtorin meqenëse është diskutuar? Dua të lidhem me çështjen e kontratës së mirëmbajtjes së parqeve dhe qytetit, ku jemi me kontrata a është lidhur kjo kontratë apo si ekziston puna e kësaj kontrate? Duke marrë parasysh që në rrugën "Anton Çeta" në Komunën e Shtimes, kanë filluar disa punime të rrjetit të kabllave të energjisë elektrike, shumë rrugica në atë lagje janë të dëmtuara. A do t'a sheh drejtoria një planifikim buxhetor në raport me rregullimin e këtyre rrugicave?

z.Atdhe Isufi: Me datë 26, rreth orës 11:00, në lagjen Komandant Kumanova, një operator që kryente sinjalizimin e rrugës ka përdorur mjete primitive duke pastruar pluhurin, dhe duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve në kohën kur në trafik ishte frekuencë dhe qarkullim i madh i nxënësve dhe i komunikacionit. Kush e ka mbikëqyrur këtë punë, a janë plotësuar standardet, dhe pse është lejuar të zhvillohet në këto kushte? Po e ngris po ashtu si çështje që lidhet me fermerët e qumështit, të cilët kanë kërkuar mbështetje për subvencionim të qumështit, siç e kanë të rregulluar edhe komunat fqinje Ferizaji dhe Lipjani. Është shqetësuese se përkundër kërkesave dhe premtimeve, deri më sot nuk ka pasur veprim konkret. Dua të theksoj që nuk ekziston një ndalim për subvencionim siç ju është thënë. Pse nuk është mbajtur takimi i premtuar me fermerët? A ekziston ndonjë pengesë ligjore konkrete? Cilat hapa konkrete do të merren brenda afatit për këtë çështje dhe a ka vullnet nga ana juaj për të u trajtuar kjo çështje?

z.Demokrat Mujota: Pyetje për DSHMS: Çështja që dua të ngris ka të bëjë me QKMF-në. Raporti i auditimit ka gjetur si të parregullta 10 pozita që janë mbajtur në mënyrë të paligjshme për 12 muaj, që i bie dy herë nga një vit. Dhe kjo është shumë keq për Komunën e Shtimes. Deshta me u ndërlidh me bartjen e nxënësve prej fshatit Mollopolc në drejtim të Shtimes. Është premtuar në vitin 2021 dhe nuk është realizuar. Prapë në 2025 i kanë fituar zgjedhjet me këtë premtim, dhe nuk po e realizojn. A ka mundësi të paktën që me ndikuar në uljen e çmimit për bileta autobusi për nxënësit e fshatit Mollopolc?

znj. Frosina Berisha Ahmeti: Pyetja ime është për drejtorin e Prokurimit, një çështje shumë interesante që ju intereson qytetarëve, pse në procedurat e tenderimit çdo herë parashihen kritere shtesë? A mund të na shpjegoni rëndësinë e këtyre kritereve shtesë, pasi është krijuar përshtypja që po favorizohen operatorë, ndërsa përjashtohen operatorë të tjerë? Pyetja e dytë ka të bëjë me kanalet kulluese, të cilat po betonizohen, pasi MMPH-ja ka nxjerrë vendim për ndalimin e betonizimit të shtretërve të lumenjve. Më intereson të di nëse jeni interesuar për të ditur se a do të zbatohet e njëjta gjë edhe për kanalet kulluese?

z.Faik Ramadani: Dua të ngre një shqetësim, që do të duhej të ishte shqetësim i madhë për Komunën e Shtimes, mungesa e shtëpisë së të moshuarve. Ju e dini më mirë se unë që në legjislaturën e kaluar në Kuvend ka ardhur një kërkesë nga z.Ramiz Kadriu për mundësinë e ndërtimit të shtëpisë së të moshuarve në Shtime. Shoqata "Jetimat e Ballkanit" ka qenë në

gjendje të gatshme që t'i ndihmojë Komunës për ndërtimin e kësaj shtëpie. A ka pasur arsye të shëndosha për të anashkaluar këtë mundësi, unë nuk e di se si ka mbetur pa u shfrytëzuar kjo mundësi e mirë? Nga ky Kuvend nga DSHP-ja ka shkuar, nëse nuk gaboj një kërkesë te z. Halil Kastrati dhe te shoqata "Jetimat e Ballkanit" për realizimin e një shtëpie të qëndrimit ditor, me sa e di unë e keni bërë një kërkesë. Nuk e di se a ju ka kthyer ajo kërkesë, a ka diçka konkrete për atë që duhet ta dijmë? A ka ndonjë zhvillimit për tokat që priten të jepen në shfrytëzim për bizneset të Komunës së Shtimes, në fshatin Gllavicë apo ka ngadalësime në projekte, apo do të kemi një spjegim më të qartë nga drejtori për këtë çështje?

z. Shefqet Krasniqi: Kam 22 pyetje, por pasi pika e parë u zvarrit shumë, po mundohem t'i klasifikoj. Principi im është t'i bëj pyetjet ashtu siç më kërkojnë qytetarët. Do të filloj nga fshati Karaqic dhe do të ndalem në Mollopolc. Banorët e fshatit Karaqicë, lagjia Kelmendi, para se të bëj pyetjen, më duhet të bëj një sqarim. Janë 5 shtëpi, prej të cilave 3 janë të dëshmorëve. Dëshmori i parë është Aziz Kelmendi i cili ju dha një zjarrë jo Serbisë, por ish-Jugosllavisë. Dëshmori i dytë është Naser Kelmendi dhe dëshmori i tretë Xhavit Kelmendi. Ata thonë kështu: "Mendojmë që kemi investuar shumë për këtë shtet dhe për këtë kuvend, përgjithësisht për komunën e Shtimes". A ka mundësi që atje të bëhet një investim vetëm për një rrugë? Sepse investitori i parë në atë trevë, që është Ramadan Kelmendi, për shkak të infrastrukturës së dobët, mungesës së rrymës dhe rrugës së vështirë, është dashur të mbyllë dy biznese që ka pasur, një me dele dhe një me pula. Atje është edhe Selman Krasniqi që mban bagëti. Pyetja e tyre është kështu: "Edhe pse na është premtuar gjatë fushatës se do ta rregullojnë këtë rrugë, ajo nuk është bërë". Kam dhënë përgjigje sepse atëherë ka qenë fushatë dhe nëse do të kishin kërkuar edhe një urë nga fshati Karaqica deri në Llapushnik, nuk do t'u kishin thënë jo. Kjo është kërkesë e tyre që të ndërhyhet. Në fshatin Karaqicë nuk po bëhet jetë, por po zhvillohet jetë. Banorët kanë filluar të punojnë tokat dhe të vendosin themelet e shtëpive. A ka mundësi që të shikohet dhe të bëhet një zgjidhje për rrugën, sepse gjendja është shumë e keqe? Ka edhe shumë çështje të tjera në fshatin Karaqicë, por këto dy janë pak më të vështira. Për më tepër, banorët thonë: "Të nderuar Asamble, javë e fundit kemi vërejtur që nuk po kallën furrat me gëlqere. Kur do të bëhet pastrimi i mbeturinave që janë afër rrugës?" Ata thonë se na është premtuar gjatë fushatës nga Armend Imeri që do të pastrohen. Edhe pse nuk e di se çfarë roli ka pasur Armendi atëherë apo çfarë detyre ka sot, por si kërkesë e tyre është që të pastrohen mbetjet e furrave të gëlqeres. Drejtori i Shërbimeve Publike nuk është këtu, por ne kemi një zgjidhje. Zgjidhja është me një kosto shumë të ulët dhe për një ditë mund të pastrohen ato mbeturina, sepse afër është një gropë shumë e madhe. Nuk kushton shumë dhe natyra do të marrë një pastrim shumë të mirë. Kërkesa tjetër është nga fshati Carralevë, nga Nexhmedin Qerkini, i cili thotë kështu: "Ka pasur një lokal, objekt para komunës. Ne e dimë sa është metri katror i banesave dhe lokaleve në mes të qendrës dhe kemi arritur një pajtueshmëri në vlerë 700 euro. E kemi pranuar këtë, edhe pse disa çështje janë në gjykatë. Edhe pse e kemi pranuar, ende nuk është bërë pagesa.. Kur do të bëhet pagesa për lokalit që kemi pasur?" Të njëjtën pyetje kam edhe nga Isak Reshani, i cili ka pasur lokal, por nuk i është bërë pagesa. Po ndalem te pjesa e rrugës "Aziz Dugolli". Atje kanë filluar punimet për shtrirjen e rrjetit të ujit, dhe kjo është një lajm shumë i mirë. Por a ka komision që i kontrollon këto punë? Ata kanë shqetësim që prerjet e rrugëve janë dëmtuar shumë, dhe pyetja e tyre është nëse do të rikthehen në gjendjen që kanë qenë më parë, edhe pse rruga "Aziz Dugolli" ka qenë shumë e dëmtuar dhe ka nevojë për riparim rishtazi. Po ndalem te Mollopolci. Këtu është pak më e dhimbshme çështja, rruga "Abedin Murtezi", pse është më e dhimbshme? Sepse me Abedini kemi qenë bashkëluftëtar, dhe e kam pas shok, dhe është dëshmor i kombit. Këtu kërkoj të më ndihmoj edhe Nënkrjetari, profa Muhamet edhe Demokradi që vinë nga Mollopolci, pse nuk është shtrur kjo rrugë a është në projekt të shtrohet kjo rrugë apo mundeni me thënë që jo në vitin 2026 apo 2027 le të hynë në projekt, sepse unë nuk e di a është në projekt mirëpo kërkojmë së paku për hirë të emrit të marrë të një dëshmori të kryhet ajo rrugë. Dhe për fund është për juve z. Kryesues dhe në seancën e fundit ne e kemi verifikuar një Komision për verifikimin e pasurisë shoqërore dhe pasurisë së Komunës dhe bëhet fjalë për ato 9 banesa dhe me

ndihmen e kolegëve kemi marrë informata që janë edhe 150 metra lokal. Nga ky Komision nga Kuvendi unë personalisht kam propozuar që të jemi nga secila parti nga 1 anëtarë, dhe në komision punues ka kaluar emri im, Faik Ramadani dhe Asllan Beqaj dhe ka pas një me u përzgjedhë nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile, a i kanë propozuar këta emra? Bëjë lutje që ky komision të filloj sa më parë në bashkpunim të plotë ashtu siq e ka thënë edhe Nënkrjetari, në bashkpunim me legjislativin edhe me ekzekutivin me rendesi është të gjejmë çelsin e këtij problemi.

znj.Erza Salija: Unë deshta me u ndërlidh me atë që tha z.Besnik. Tha që është planifiku nga ekzekutivi vlerësim apo shikim i terenit, por pyetja ime është sa pritët me zgjatë ky proces sepse në lagjen të cilën e veçoj ka 10 vite që gypat për kanalizim janë vendos mirëpo nuk janë funksional, as gjatë kohës sa ka udhëheq PDK-ja, dhe as për këto katër vite që keni udhëheq ju si LVV. Sa kohë ju duhet juve për me i fillu punimet?

z.Bajram Hajrizi: Qato mbledhje të cilat i kemi mbajtur, edhe unë i kam parashtruar disa pyetje, por fatkeqësisht asnjë përgjigje nuk kam marrë nga asnjë drejtor apo drejtoreshë, me përjashtim të një përgjigjeje nga Nënkrjetari, të cilën e ka dhënë për rastin e Tom Gashit. Të tjerat nuk i kam marrë fare. Edhe unë kam shumë pyetje që m'i kanë dërguar qytetarët e Komunës së Shtimes, mirëpo në këtë seancë dua ta ngre si shqetësim çështjen e Kompleksit Memorial të Martirëve. Desha t'ia bëj një pyetje ekzekutivit: A jeni në dijeni se është ndërprerë mirëmbajtja e kompleksit memorial nga agjencia përkatëse? Ata djemtë të cilët e kanë bërë këtë punë me krenari dhe dinjitet sot nuk marrin paga. Dua të them se ne, si banorë të Reçakut, jemi në gjendje edhe vetë ta mirëmbajmë Kompleksin Memorial, sepse e kemi obligim moral dhe kombëtar. Por do të doja nga institucionet lokale dhe qeveritare, meqë e keni pushtetin edhe këtu edhe në Prishtinë, të na japin një përgjigje, sepse nuk guxojmë të heshtim përballë kësaj gjendjeje që po përjeton Kompleksi Memorial.

z.Besnik Seferi: Mbete pak borgj për Komisionin që është formuar në kompleksin e banesave "Fitorja" në Komunën e Shtimes. Ne nuk kemi qenë prezent dhe unë ndoshta do të nisesha nga pyetja që e bëri z.Shefqet Krasniqi, se si do të organizohet kjo pjesë e këtij komisioni. Megjithatë, po flas për veten time, nuk jam kundër këtij komisioni, sepse aty kemi me pa ku janë dhe si janë gjërat, por të formohet komisioni pa e ditur se ne jemi pjesë e tij, kjo m'u duk e pa drejtë.

znj.Fatlinda Rrafshi: Në rrugën "Anton Çeta" është duke u bërë rrjeti i energjisë elektrike për toke, deshta me pyetë ekzekutivin se KEDS-i a ka me kthyer rrugën e asfaltuar në gjendjen e mëparshme e cila është dëmtuar, apo është detyrë e ekzekutivit? Po ashtu në rrugën "Anton Çeta", mbrëmë kanë vendos me i bërë vijat e bardha, mirëpo pa e bërë pastrimin e asfaltit paraprakisht. Dhe në mëngjes disa veqse ishin fshi, sepse ngjyren se ka marrur shumë për shkakë të pluhurit?

z.Demokrat Mujota: Desha të ndërlidhem me z. Shefqetin. Rruga "Abedin Murtezi" në Mollopolc, si rrugë kryesore e lagjes, është asfaltuar moti. Degëzimi i saj brenda lagjes, që përfshin rrugën më të gjatë, mund të jetë rreth 150 metra, ku përfshihet edhe shtëpia e djalit të axhës së dëshmorit Abedin Murtezi dhe shumë të tjerë, është ende e pashtuar. Tjetra është rruga te Muhamet Ismajli, edhe ajo pjesë afërsisht 60 metra, është e pashtuar. Është premtuar, por nuk është realizuar.

znj.Erza Salija: Desha të ndërlidhem me Besnikun. Gjatë kohës që kemi qenë në bashkëqeverisje me LVV-në, ne si LDK kemi pasur në përgjegjësi Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Drejtorinë për Rini, Kulturë dhe Sport, si dhe Drejtorinë e Bujqësisë. Kjo nuk do të thotë se ato drejtori kanë qenë përgjegjëse për kanalizimin. Prandaj, edhe pse kemi qenë në bashkëqeverisje, përgjegjësia mbetet prapë e juaja.

z.Faik Ramadani: Po ndiej pak përgjegjësi, madje më shumë për këtë punë, sepse në ditët e para kur ajo kompani ka filluar punimet, unë kam dalë në terren dhe me mirësjellje u kam kërkuar zyrtarëve të asaj kompanie sqarime se çfarë do të ndodhë, sepse kisha parë edhe disa video me shumë defekte. Kur diskutova me ta, më dhanë premtimin se do ta rregullojnë çdo gjë dhe do t'i kthejnë rrugët në gjendjen e mëparshme. Përveç kësaj, kam biseduar edhe me Kryetarin. I kam shënuar shqetësimet dhe e falënderoj Kryetarin e Komunës që atë ditë i ka

dërguar dy inspektorë, sepse unë e kam ngritur këtë shqetësim dhe kam kërkuar që prerjet të bëhen ashtu siç duhet dhe rrugët të kthehen në gjendjen e mëparshme.

z.Haqif Arifi: Kisha me fillu me dy drejtori: kur do të fillojnë punimet në fshatin Gjyrkocë për asfalt, trotuar, ndriçim, kanalizim dhe ujësjellës? Po flas për punët që kanë filluar, janë premtuar dhe kanë mbetur në gjysmë. Kur është fjala për kanalizimin, ka pasur kërkesa dhe vizita të shumta, mirëpo këtu kërkoj që jo vetëm zyrtarët të shkojnë me vetura për vizitë, por të formohet një ekip ekspertësh, të cilët personalisht do ta bënin inçizimin e gjendjes faktike dhe do të vlerësonin se ku duhet intervenuar. Konkretisht, bëhet fjalë për rrugën "Arifi", te familja Hoxha. Punë të tjera kanë filluar edhe në fshatin Gjyrkocë, por qytetarëve dhe mua na interesojnë ato punë, ato rrugë dhe ato premtime që janë dhënë dhe kanë mbetur në gjysmë. Kur do të fillojnë të realizohen? Kam edhe një pyetje për kolegun Besnik Seferi, i cili në mbledhjen e kaluar doli në foltore dhe tha se ju keni marrë meditje dhe po luftoni të merrni meditje. Kisha kërkuar nga kolegu që të na tregojë se kur kemi marrë meditje, duke folur për legjislaturën aktuale dhe jo për para 20 viteve. Kam bërë edhe një kërkesë para dy muajsh për drejtorin e prokurimit, pse është hequr legalizimi i fushës nga projektet, kur ai e di shumë mirë se kjo pikë ka kaluar në Kornizën Buxhetore 2026–2028 dhe është aprovuar e buxhetuar? Pa kërkesën e askujt, ajo pikë është larguar. Kam një pyetje edhe për auditimin në lidhje me Kryetarin, mirëpo ai nuk është këtu. Prandaj po ja drejtoj Nënkryetarit, si e arsyetoni faktin që auditimi ka dhënë opinion të kualifikuar për Komunën, dhe kush përgjigjet për 94 mijë euro për procedura të pambaruara?

z.Besnik Seferi: Unë thashë për ta korrigjuar kolegun. Nëse nuk është kështu, është mirë të dëgjohej edhe videoja. Kam thënë që këto meditje të ndahen. Nëse ky nuk është realitet, ju e dini shumë mirë se ka disa komisione që ligjërisht, i kanë takuar edhe LVV-së për shkakë të grupit më të madhë. Kam thënë që këto meditje të ndahen.

z.Haqif Arifi: Nëse është përdorur arroganca e votave, unë besoj se edhe anëtarët e LVV-së, LDK-së dhe PDK-së janë qytetarë të Komunës së Shtimes. Me çfarë arrogancë, në aspektin nacional, në rajon të Kosovës dhe nëpër borde, asnjë nuk ka shkuar prej këtyre dy subjekteve? Kjo është një padrejtësi. Unë e di që edhe aty e keni fuqinë dhe e keni shfrytëzuar. Ndërsa auditimi, me të gjeturat e tij, është bazuar pikërisht në faktin se ju, në këtë rast e keni shkelur Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren për Prokurimin dhe Menaxhimin e Pronës. Këto janë të gjeturat e auditimit, të bazuara në këto ligje.

z.Asllan Beqaj: Në mandatin e kaluar, pyetjet janë bërë nga asambleistët dhe i kemi marrë përgjigjet nga ekzekutivi, dhe kështu është përfunduar si pikë e rendit të ditës.

z.Bajram Hajrizi: E tha që edhe LDK-ja edhe PDK-ja, për sa më kujtohet janë dakorduar për t'i ndarë bordet. A bënë me na tregu kush të ka pajtu ty që të ka emëruar në vitin 2022 si anëtar të Komisionit të KRM "Pastrimi", njësia në Shtime?

z.Shefqet Krasniqi: I bashkëngjitem kërkesës së z.Beqaj, mirëpo le t'i dëgjojë edhe ekzekutivi pyetjet që po i bëjmë, sepse gjatë fjalimeve tona po ka shumë ndërhyrje dhe pastaj po zgjatet tema.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi Do të mundohem t'u jap përgjigje atyre pyetjeve që kam arritur t'i shënoj. Pyetja e parë është për kanalizimet. Gjatë mandatit 2022–2025 është punuar shumë në drejtim të kanalizimit, ndriqimit, asfaltimit dhe trotuareve. Ndoshta ka ndonjë problem me kanalizimin ose me gropat septike, sepse nuk kemi arritur t'i mbulojmë të gjitha si qeverisje. Por prapë po e them se si Lëvizje Vetëvendosje dhe Lidhje Demokratike, në vitet 2022–2025 kemi punuar në këtë drejtim. A do të bëhen edhe ato që kërkon? Është shumë e thjeshtë, i kemi dëgjimet publike dhe draft-kornizën afatmesme buxhetore. Të gjitha kërkesat tuaja mund t'i adresoni në buxhet dhe ato që janë prioritare do të futen dhe do të procedohen më tutje. Sa i përket Shtëpisë së të Moshuarve, me z. Ramiz Kadrija kam komunikuar personalisht. Ajo që është thënë nuk është e vërtetë. Kam pasur dy takime edhe me z.Halil Kastrati. Është e vërtetë që ai ka bërë kërkesë, por ti si Ramiz nuk mund të bësh kërkesë në emër të z.Halil Kastratit.

z.Demokrat Mujota: Të përgëzoj për përgjigjen Nënkryetar. A jeni krenar si ekzekutiv komunal që më 15 Janar këtyre asambleistëve ua keni mbyllur derën e Komunës dhe derën e Kuvendit, duke e pasur Kryesuesin dhe anëtarët brenda, dhe duke i ndaluar ambasadorët të marrin pjesë?

Meqenëse po thoni se nuk bëni politikë me Reçakun, atëherë pse e keni mbyllur derën më 15 janar? Po i drejtohem ekzekutivit.

znj.Fatinda Rrafshi: Projekti ka qenë për Shtëpinë e të Moshuarve dhe ka qenë projekt para atij të Vushtrisë. Atë projekt nuk e keni pranuar dhe arsyen e dini ju. Projekti të cilin e ka bërë z.Ramiz në bashkëpunim me z.Halil Kastrati, kërkesa është bërë më 9 gusht 2023. Të gjitha ato që i the bien poshtë, sepse z.Halil Kastrati ka dashur të bashkëpunojë dhe e ka ofruar bashkëpunimin me 2.5 milionë euro. Ai projekt ka qenë para atij të Vushtrisë.

z.Bajram Hajrizi: Mjafton vetëm një fotografi për ta parë gjendjen e Reçakut. Për Reçakun kurrë nuk është bërë mjaftueshëm, mirëpo gjatë këtyre pesë viteve mandat nuk keni bërë asgjë. Çdo banor i fshatit Reçak është në gjendje ta mirëmbajë vetë, personalisht, Komplexin Memorial.

z.Asllan Beqaj: E para, uroj që ky komision të jetë ligjor. Më pak e rëndësishme është nëse emri im është në komision apo jo. Thjesht uroj që ky komision të themelohet dhe të funksionojë në mënyrën më të mirë të mundshme.

znj.Erza Salija: Pyetje për Nënkryetarin. A jeni në dijeni se në fshatin Reçak banorët vazhdojnë të kenë mungesë të ujit dhe sa herë që kërkojnë ndihmë, ju thuhet se kjo është kompetencë e KRU Prishtina? A keni planifikuar si institucion të ndërmerrni hapa konkretë ose ndonjë iniciativë zyrtare për zgjidhjen e këtij problemi? Banorët e fshatit Reçak janë lodhur nga kjo situatë.

z.Atëdhe Isufi: Pse është lejuar operatori të punojë gjatë ditës për kryerjen e punimeve të sinjalizimit? Pyetja e dytë, është premtuar subvencionimi i fermerëve të qumështit nga Kryetari, por kjo nuk është realizuar kurrë.

z.Faik Ramadani: Desha të them se në këtë pjesë jam shumë i përgatitur. Përveç tjerash, z.Ramiz Kadriu është shok i imi dhe një nga humanistët më të mëdhenjë të Komunës së Shtimes. Ka marrë pjesë në dhjetëra aksione humanitare. Për aksionin e Shtëpisë së të Moshuarve ka thënë se do të japë 5 mijë euro vetëm nga dëshira që ai projekt të realizohet. E ka pasur shumë personale këtë çështje. Më e mira është se z.Ramiz është gjallë dhe mund të ulemi e të bisedojmë me të. Oferta ka qenë shumë serioze, por më pas është neglizhuar.

z.Haqif Arifi: Unë kam kërkuar nga Kryetari që së paku drejtorët të vijnë në seancë. E bëra një pyetje, kur do të fillojnë projektet e propozuara dhe të miratuara që do të realizohen në Gjyrvokovc? Nuk mora përgjigje. A ka mundësi të formohet një ekip ekspertësh që të shkojë në vendngjarje dhe të bëjë inçizimet e nevojshme? As për këtë nuk mora përgjigje. Kështu që vetvetiu po na impononi t'i përsërisim pyetjet.

z.Muhamet Ademaj: E kam një pyetje për znj.Fatlinda dhe z.Ramadani. Pse kërkesa e z.Ramiz ka qenë që objekti të ndërtohet te Enti Special, dhe jo në pjesë të tjera të territorit të Komunës së Shtimes?

z.Fatlinda Rrafshi: Nuk ka qenë për te Enti Special, sepse në atë kohë nuk ka qenë as Enti Special dhe nuk ishte planifikuar as në Mollopolc. Ky ka qenë propozim i z.Faik, z.Ramiz ka kërkuar vetëm pronën për ndërtim, ndërsa mjetet kanë qenë të ndara veçmas.

z.Faik Ramadani: Ideja për adaptimin ose akomodimin e objekteve të Entit Special ka qenë ideja ime, për ta shfrytëzuar atë mundësi si Komunë e Shtimes. Ndërsa ideja e z.Ramizit nuk ka qenë e lidhur me lokacionin, por me kërkesën që Komuna të gjente një lokacion të përshtatshëm, gjë që në atë kohë nuk kemi mundur ta realizojmë.

z.Demokrat Mujota: Nënkryetar pyetja ime ishte te premtimet e Kryetarit Aliu për nxansat e fshatit Mollopolc që ka bërë në vitin 2021, e ka bë edhe në vitin 2025 e që nuk është realizuar asnjëherë, p.sh. nxënsat e fshatit Mollopolc me ardhë në shkollë me një minibus në Shtime siç janë të rregulluara në disa fshatra. Ka qenë premtim edhe mandatin e kaluar edhe tash.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Të gjitha premtimet që janë bërë nga z.Qemaj Aliu i kam dëgjuar personalisht. Ai ka premtuar transport për nxënësit parashkollorë të lagjes Ademaj në Mollopolc dhe të pjesës së Tërshanëve drejt shkollës së Petrovës, jo për në Shtime. Ligji nuk lejon transportimin e nxënësve të shkollës së mesme nga komuna.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pas kërkesave për pauzë, shkojmë në pauzë në orën 13:10. Vazhdojmë me mbledhje në orën 14:24. Konstatoj kuorumin prej 16 anëtarësh, dhe do ta konsideroja të mbyllur këtë pikë, sepse mjaft diskutuam.

z.Grejtalb Emini, DZHE: E para, desha të ndërlihem te Reçaku, sepse kam qenë pjesë e një çështjeje të rëndësishme. U ngrit si temë se nuk është bërë asgjë për Reçakun. Shtëpia e mësuesit Sadik ka 25 vite që ka qenë e pashpronësuar dhe ka një vlerë mbi 250 mijë euro. Është e vetmja shenjë e Reçakut që ka mbetur për 25 vite pa u rregulluar.

z.Bajram Hajrizi: Është e vërtetë që e keni bërë shpronësimin të shtëpia e mësuesit Sadik, por e keni bërë pasi që ata kanë dalë në televizion dhe kanë bërë ankesë. Edhe kur thashë që nuk bëj politikë me Reçakun, ti si drejtor nuk ke qenë në gjendje të vish dhe ta shikosh rrugën "Ahmet Kaqiku", e cila është pa urë dhe nuk i shërben nevojave të fshatrave. Ato dy ura që janë rregulluar, mirë është, por edhe kjo urë ka pasur nevojë të rregullohet. Shiko infrastrukturën, e ke ngushtuar trotuarin dhe shiko këtë pusët; nuk keni qenë në gjendje për katër vite, si drejtor, ta rregulloni.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi që nuk ka diskutime, vazhdojmë me pikën tjetër.

Pika 3

Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029 (për diskutim publik)

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Fjalën ja dha z.Besnik Ahmeti

z.Besnik Ahmeti DBF: Lexo materialin si në vijim (*shiko dokumentin*).

z.Muhamet Ademaj: E falënderoj z.Ahmeti për prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2027–2029. KAB-i është vetëm një udhëzues, që i paraprin hartimit të buxhetit. Ne pajtohemi që ky dokument të shkojë në diskutim publik. I ftoj qytetarët të marrin pjesë në diskutimet publike, sepse pas tyre do ta dimë se cilat janë kërkesat e qytetarëve për investime kapitale, sidomos për projektet kapitale.

z.Shefqet Krasniqi: Nuk e kam parë nëse keni planifikuar diçka për subvencionimin e bujqëve, duke qenë se e dimë që shumë familje merren me bujqësi dhe blegtori. Nuk e kam hasur në këtë planifikim që do të bëhet diçka për bujqit, ose së paku t'u ndihmojmë me pleh apo me farë.

Dhe e dyta, te Drejtoria e Kulturës kam një pyetje. Edhe para luftës, edhe tani, Shtimja njihet me djem dhe vajza sportdashëse që na kanë bërë të ndihemi mirë. Nuk pashë askund që keni planifikuar ndihmë për ekipet e futbollit dhe sporteve të tjera, prandaj kërkoj që të ketë diçka edhe për këtë kategori.

z.Faik Ramadani: Për fillim, nga sa e kam parë unë, po mundohem të mos e zgjas. Për mua kjo është e paqëndrueshme dhe besoj se do të rishikohet. Mirëpo dua të di sa janë mundësitë që të rishikohet, sepse ka mundësi të ndodhë si me rastet e tjera ku nuk kemi mundur të ndryshojmë asgjë. Po flas me fakte. Për pikat që kam propozuar, asnjë nga kërkesat që kam bërë deri më tani nuk janë përfshirë në këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore. Dua të di saktësisht sa është mundësia dhe përqindja e ndryshimeve, sepse këtu disa projekte janë me kode dhe ne do të kalojmë nga mbledhja në mbledhje e në fund do të vijmë te një pikë ku duhet ta votojmë patjetër. Dua një sqarim konkret: a do të vazhdojë kështu, apo do të ketë diskutim publik dhe do të përfshihen projektet më bazike që u nevojiten qytetarëve të Shtimes?

z.Haqif Arifi: Desha ta bëj një pyetje të thjeshtë. Ky planifikim është bazuar në Kornizën Afatmesme për vitet 2027–2029 dhe në PZHK-në e PZHU-në e viteve 2009 dhe 2020, kur këto dokumente janë të skaduara prej së paku gjashtë vitesh. A ende po bëhen projekte duke u bazuar në këto plane zhvillimore? Gjithashtu, askund nuk u përmend Zona Ekonomike e Gllavicës. Në projeksionet e këtij drafti për fshatin Gjyrkovc janë përfshirë disa projekte që tashmë janë kryer ose janë duke u kryer, si trotuari dhe ndriçimi në rrugën "Fehmi Agani", ndriçimi në rrugën "Arifi" dhe në rrugën "Emin Halili". Kanalizimi mbetet shqetësues dhe e përmenda edhe më herët se kërkon një ekip profesionist të fushës përkatëse. Kanë mbetur shumë punë pa u përfunduar dhe ende ka rrugë të pashtuara, me zhavorr dhe pa ndriçim. Pajtohem që pas dëgjimit publik të evidentohen dhe të përfshihen përsëri, por ato që janë kryer të mos futen dy herë.

z.Fatlinda Rrafshi: Unë kam një paqartësi te projekti për rregullimin e pishave. Në buxhet është aprovuar për vitin 2027 shuma prej 20 mijë eurosh, ndërsa tani përmes KAB-it figuron shuma prej 300 mijë eurosh. Kjo do të thotë se 270 mijë euro janë grand qeveritar dhe 30 mijë euro janë të hyra vetanake. Projekti është planifikuar të përfundojë në vitin 2027, por është zgjatur edhe për një vit, deri në vitin 2028, me një shumë shtesë prej 30 mijë eurosh.

z.Shefqet Krasniqi: Drejtor, një pyetje konkrete. A ka mundësi të na prezantoni se nga cilat projekte të planifikuara për investime, po i merrë mjetet përmbaruesi? Ju lutem, nëse e keni të specifikuar, është mirë të na njoftoni që të mos mbajmë shpresa të kota dhe t'u tregojmë qytetarëve se një projekt nuk mund të realizohet sepse mjetet i ka marrë përmbaruesi.

z.Besnik Ahmeti, DBF: E diskutuam që në fillim se ky buxhet është draft dhe do të shkojë në diskutim publik, prandaj mund të ndryshojë gjithçka. Ka projekte që janë planifikuar me një shumë tjetër dhe u është rritur vlera për shkakë se nuk kanë filluar këtë vit dhe pritet të fillojnë vitin tjetër, qoftë për shkak të vendimeve gjyqësore apo procedurave të tjera. Sa u përket projekteve të reja që ende nuk kanë filluar, si Drejtori e Financave së bashku me ekzekutivin kemi planifikuar të mos fillojmë projekte të reja, sepse kemi projekte të vjetra të kontraktuara që duhet t'i përfundojmë.

z.Haqif Arifi: Drejtor, unë pyeta pse ende Komuna mbështetet në planet zhvillimore PZHU dhe PZHK, të viteve 2009 dhe 2020?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Buxheti mbështetet plotësisht në qarkoren e parë. Drafti është përgatitur bazuar në qarkoren e parë të datës 15 maj. Presim edhe qarkoren e dytë të datës 15 gusht dhe pastaj do ta definojmë secilën pikë.

z.Demokrat Mujota: z.Arifi pyeti si është e mundur që projekte të përfunduara në vitin 2025 të paraqiten si të planifikuara edhe në qarkoren e vitit 2027, kur ato tashmë kanë përfunduar?

z.Besnik Ahmeti: Te të hyrat e bartura është një projekt me vlerë 11 mijë e 338 euro. Ky projekt është i vitit 2024 dhe është marrë nga përmbaruesi. Nëse një projekt e merr përmbaruesi, nuk ke zgjidhje tjetër përveçse ta buxhetosh përsëri.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Buxheti në secilën komunë, por edhe në nivel qendror, ndahet sipas numrit të banorëve dhe pozitës gjeografike. Këto janë projeksione për vitet 2027–2029. E tha edhe drejtori se një projekt që është i buxhetuar dhe ka kod të veçantë, përsëritet çdo vit.

z.Haqif Arifi: Nuk pyeta si të votohet ky projekt. E pyeta Drejtorinë e Financave se sa mendon Komuna që ky projekt buxhet për vitet 2027–2029 do të jetë i suksesshëm, kur ende mbështetemi në plane zhvillimore të vjetra. Mendova se do të thoshit se jeni duke punuar në këtë drejtim. A është ky plan më shumë zhvillimor apo administrativ? Dhe për çfarë kanë nevojë më shumë banorët e Shtimes, plane operative, administrative apo zhvillimore?

z.Demokrat Mujota: E kam një pyetje për Nënkryetarin, Drejtoria e Agjencisë për Komplekse Memoriale ka bërë disa investime në Komunën e Shtimes. Në fshatin tim, Mollopolc, është bërë investimi i kullës së Kompleksit Memorial të Zonës Operative të Nerodimës. Po ashtu, në fshatin Reçak janë dy shtëpi, ajo e Sadik Osmanit dhe ajo e Zukë Mustafës, të cilat i ka realizuar Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale. A futen këto investime në kuadër të Komunës apo konsiderohen investime të agjencisë?

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Çështja është se Plan i Zhvillimor Komunal është i skaduar, dhe duhet të punojmë me planin e vjetër.

z.Shefqet Krasniqi: Në vitin 2022, Komuna përmes prokurimit dhe një kompanie kanë bërë marrëveshje për përfundimin e një rruge, por pagesa nuk është bërë, pasi përmbaruesi po i merr mjetet dhe Komuna nuk ia ka bërë pagesën kompanisë. Për shembull, pagesa është dashur të ekzekutohej në vitin 2023, por kompanisë i është thënë se nuk ka mjete, sepse ato i ka marrë përmbaruesi. A ka kamata dhe ndëshkime ndaj operatorit që e ka kryer punën, dhe cilat janë humbjet tona? Problemi është mos kryerja e pagesave me kohë, sepse kjo sjellë interesa dhe ndëshkime.

z.Besnik Ahmeti DBF: Për atë arsye thashë se bartja e të hyrave është dashur të kalojë sot, sepse kemi pasur tri vendime gjyqësore dhe tri vendime të përmbaruesit, ndërsa njëri ka ardhur pasi e kam dorëzuar materialin në Kuvend. Deri në momentin e alokimit të mjeteve, ato bartin kamata ndëshkuese.

z.Haqif Arifi: Do të ishte mirë që në draft të paraqitej edhe një analizë e punëve të kryera dhe të pakryera, sidomos te projektet grupore. Do të ishte mirë të thuhej, për shembull, se në fshatin Gjyrvoc, projekti është kryer dhe nuk ka nevojë të përfshihet më, por duhet të vazhdohet në Muzeqinë etj.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2027-2029. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Komiteti për Politikë dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyra për Informim.**

Pika 4

Raporti i Auditimit për PVF të vitit 2025 për Komunën e Shtimes nga ZKA

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Fjalën ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti DBF: Lexoi materialin si në vijim (*shiko dokumentin*).

z.Shefqet Krasniqi: Raportet e FMN-së e kanë renditur Kosovën ndër vendet më të varfra në Evropë. Kur thuhet se të gjitha komunat kanë dalë më keq se Shtimja, kjo nuk më bën përshtypje. Do të doja që të gjitha komunat të performonin mirë, por mua më intereson më së shumti Shtimja. Nuk është ndonjë krenari të thuhet se komunat e tjera kanë dalë më keq se ne. Në KPF keni thënë se ndiheni shumë komod me këto të gjetura, ndërkohë që ka rekomandime të përsëritura. Si funksionon kjo? Ne si Komunë nuk kemi qenë në gjendje t'i përmirësojmë rekomandimet e mëhershme.

z.Besnik Seferi: Më e mira do të ishte të mos kishte asnjë gjetje të re dhe asnjë të përsëritur. Një pjesë e gjetjeve të përsëritura lidhen pikërisht me kontratën kolektive.

z.Fatlinda Rrafshi: Pyetje për Nënkryetarin. Pasi që e njihni mirë legjislacionin, a u keni propozuar kolegëve të ekzekutivit masa për të mos u përsëritur këto gabime, apo vetëm neve si asambleist, na thoni se MAPL-ja e kthen mbrapsht vendimin? Realisht, auditori i ka kthyer ato si rekomandime për zbatim.

z.Muhamet Ademaj: Vetë natyra e punës së auditorit është e tillë që të identifikojë gjetje dhe të japë rekomandime. Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre 3 janë të reja, 6 të përsëritura dhe 1 pjesërisht i zbatuar. Te rekomandimet e auditorit nuk kemi të bëjmë me keqmenaxhim, por me rekomandime që ndihmojnë përmirësimin e punës së ekzekutivit. Duhet të dimë sa janë zbatuar këto rekomandime.

z.Demokrat Mujota: Vetë fakti që auditori jep rekomandime tregon mënyrën se si duhet të kryhet puna. Kjo është mbledhja e katërt që e kam ngritur si shqetësim çështjen e kontratës kolektive. Na ka ardhur rekomandimi që Kryetari i Komunës duhet të gjejë bashkëpunim me Ministrinë e Financave për ta zgjidhur çështjen e realizimit të shpenzimeve të kontratës kolektive, në mënyrë që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen sipas kodeve ekonomike adekuate. Kontrata kolektive është bërë me marrëveshje të ministrave dhe kryetarëve të komunave. Në atë kontratë shkruan se obligohet qeveria dhe ministria për realizimin e saj. Nëse nuk ka vullnet politikë nga komuna apo ministria, atëherë problemi qëndron aty. Ky nuk është vetëm problem i Komunës së Shtimes, por i të gjitha komunave. Pa bashkëpunim mes nivelit qendror dhe atij lokal nuk mund të gjendet zgjidhje.

z.Asllan Beqaj: Raporti ndër vite është duke u përmirësuar, sa u përket gabimeve teknike dhe rekomandimeve të tjera. Sa i përket kontratës kolektive, ajo është përsëritur edhe vitin e kaluar dhe do të përsëritet edhe në të ardhmen nëse nuk gjendet zgjidhje nga qeveria. Komunat nuk e kanë fuqinë ta zgjidhin vetë këtë çështje.

z.Haqif Arifi: Mund të them se elaborimi i drejtorit për gjetjet e auditimit ishte ndër më të mirët. Gjetjet janë bërë duke u bazuar në Ligjin për Financat Publike, Ligjin për Tatimin në Pronë, Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe rregulloret për prokurim dhe menaxhim të pasurisë. Unë kërkoj hartimin e një plani të plotë për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të auditorit, raportim tremujor në Kuvend për progresin, marrjen e masave për shmangien e përmbarimeve dhe kostove gjyqësore, rritjen e efikasitetit në tatimin në prone, rritjen e transparencës, përmirësimin

e menaxhimit të pronës komunale, forcimin e kontrollit të brendshëm në prokurim dhe menaxhim.

z.Atdhe Isufi: Kam një pyetje lidhur me ushtruesit e detyrës. Kush është përgjegjës për faktin që drejtorët nuk janë emëruar me kohë ose pse nuk është hapur konkursi? Nuk e dëgjova askënd ta përmendte këtë si gjetje të auditimit. Mua nuk më duket e rregullt dhe nuk besoj se kontrata kolektive ka ndikuar në këtë çështje.

z.Bajram Hajrizi: Raporti i auditimit për vitin 2025 ka dhënë opinion të kualifikuar për Komunën e Shtimes. Kjo do të thotë se auditori ka gjetur probleme në mënyrën e menaxhimit të parasë publike. Janë bërë pagesa për punë ose shërbime pa dokumentacion të rregullt. Disa shpenzime janë regjistruar gabimisht në libra, ndërsa disa fatura nuk janë regjistruar me kohë ose saktë. Për qytetarët e Shtimes, kjo do të thotë se paratë publike nuk janë menaxhuar me kujdes të mjaftueshëm dhe nuk ka pasur kontroll të mjaftueshëm. Këto nuk janë çështje të vogla dhe kërkojnë përgjegjësi. Gjithashtu duhet theksuar se kontrata kolektive nuk ka ndikuar në opinionin e kualifikuar.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Edhe në Komitet kam thënë se ndihem komod me faktin që kemi vetëm tri rekomandime të reja. Asnjë prej rekomandimeve, qofshin të reja apo të përsëritura nuk përmban elemente të veprës penale dhe nuk paraqet lëndë për hetim.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: U përmend çështja e disa faturave të papaguara. Jam konsultuar për këto raste. Për shembull, në një rast operatori teknik, në vend që të vendoste 11 metra perde, kishte vendosur vetëm 6 metra. Për raste të tilla ekziston prokuroria. I inkurajoj të gjithë që për çdo problem, qoftë nga viti 2018 apo vitet në vijim, të veprojnë sipas ligjit. Sa i përket gjetjeve, opinionin mbetet ai që e ka dhënë auditori.

z.Shefqet Krasniqi: Të nderuar kolegë nga LVV dhe PDK, gjatë debatit keni akuzuar njëri-tjetrin për periudhat kur keni qeverisur Komunën dhe për gjetjet e auditorit. Për këto arsye, mendoj se kjo komunë duhet të udhëhiqet nga LDK-ja.

z.Demokrat Mujota: I inkurajoj dy drejtorët, z.Emini dhe z.Ahmeti, që për të gjitha të gjeturat, gabimet, dështimet dhe pretendimet për hajni nga qeverisja e kaluar, kur kanë qenë në pushtet, nëse i gjejnë dhe kanë fakte, nuk guxojnë të mos i dërgojnë në Prokurori dhe Gjykatë. Ju lutem shumë, më jepni mua dhe unë i dërgoj. Unë jam shumë i interesuar, edhe z. Jakupi, edhe secili prej neve, që të krijojmë një grup hetimor për këto gjëra, si për kohën e PDK-së ashtu edhe për kohën tuaj. Hajnat e kanë vendin në burg dhe jo në institucione, pa marrë parasysh kush janë.

Jam unë Demokrat aty nëse jeni ju. Ti je drejtor financiar dhe deshta të ta bëj një pyetje, si ka mundësi që një drejtor i Komunës me pagë 750 euro dhe me mandat 4-vjeçar të blejë 5-6 prona, 2 apo 3 banesa, të blejë dhe të ndërrojë 5 apo 6 vetura brenda një mandati, të hyjë në biznes të madhë, të hapë fabrikë dhe të blejë prona? Si mund t'i blejë të gjitha këto me 750 euro? Po për z.Grejtalb Emini, e kam fjalën.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Pyetja e parë është, a po na jep këshilla neve si Kuvend apo po i jep këshilla ekzekutivit? Është shumë e vërtetë se atë që e di dhe që është profesionale e jap si këshillë nga përvoja. E tha edhe drejtori që disa rekomandime të auditorit është problem të eliminohen, sepse janë që nga viti 2012 për shkak të pagesave të pronave. Sot, nëse e kishit miratuar bartjen e të hyrave, ne do t'i kishim filluar pagesat pas 7 ditësh.

z.Besnik Ahmeti DBF: E diskutuam për buxhetin në bazë të përvojës, kështu që po e ftoj edhe asamblenë që, brenda afateve ligjore dhe brenda muajit qershor, të paraqesë projektet e veta. Drejtoria e Financave e ka derën e hapur për çdo projekt dhe diskutim publik. Ju presim në çdo kohë për çfarëdo propozimi. Mos ta lëmë buxhetin për ditët e fundit, siç e kemi lënë vitin e kaluar.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi që ky raport vjen nga një institucion i pavarur nuk votohet. Andaj kalojmë te pika tjetër.

Pika 5

Shqyrtimi i kërkesës për ndërhyrje nga KEDS-i, në rrjetin e energjisë elektrike në fshatin Pjetërshticë

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutim për këtë pikë.

z.Shefqet Krasniqi: Kemi diskutuar gjatë; ka qenë një pikë e rëndësishme për secilin në komitet dhe me të vërtetë ka telashe në tërë Kosovën me KEDS-in. Është krijuar një narrativë sikur ata janë shtet në vete. Megjithatë, qytetarët duhet ta kuptojnë se nuk ka mundësi që jo vetëm Komuna e Shtimes, por as komunat e tjera të ndërhyjnë fuqishëm në këto imponime. Kemi rekomanduar dhe insistuar që e gjithë asambleja të ketë një takim me përfaqësues të KEDS-it dhe të diskutojmë për këto çështje, jo vetëm për Pjetërshticën. Gjatë seancës më janë dërguar edhe fotografi dhe, ajo që është më e keqja, përveç mungesës së trafave kemi edhe shumë shtylla të rrëzuara në tokë, të cilat paraqesin rrezik për fëmijët tanë dhe për kafshët. Duhet të merremi fillimisht me këto shtylla të rrëzuara, sepse rrezikojnë jetën e qytetarëve. Është mirë të gjejmë një mënyrë për t'i thirrur përfaqësuesit e KEDS-it. Nëse bëhet trysni edhe nga Kryetari, ndoshta do të ketë intervenim. Ky është shqetësim jo vetëm për Pjetërshticën, por për çdo familje. Po jap një shembull nga lagjja Goden: janë mbjellë 1350 fidanë arrash dhe 450 trupa dardhash. Këto i gjeni në Drejtorinë e Bujqësisë. Projekti ka dështuar sepse aty ka ujë mjaftueshëm, por nuk ka energji elektrike dhe as trafo. Unë vetë kam investuar mbi 10 mijë euro për shtylla betoni dhe sa herë kam bërë kërkesë për pranimin e orës elektrike, nuk ma kanë pranuar. Uroj që si Kuvend, si ekzekutiv dhe si legjislativ, të marrim një vendim dhe të kemi përfaqësues të KEDS-it këtu për këto ndërhyrje.

z.Faik Ramadani: Besoj që pajtoheni të gjithë se problemi nuk është vetëm në Pjetërshticë. Sot po shqyrtojmë kërkesën që e kemi përpiluar si fshat. Aktivistët e fshatit kanë dashur të vijnë këtu dhe të qëndrojnë gjatë kësaj pike të rendit të ditës. Fillimisht po e lexoj kërkesën që të dimë saktësisht çfarë kemi kërkuar. Në vazhdim lexoi kërkesën e fshatit Pjetërshticë (*shiko dokumentin*). Ideja që kemi marrë në Komitetin për Politikë dhe Financa është që të ftohen disa anëtarë të KEDS-it dhe të gjejmë një mënyrë zgjidhjeje, sepse me të vërtetë është bërë një jetë e padurueshme. Ju falënderoj të gjithë anëtarëve që kanë dhënë kontribut për këtë pikë.

z.Asllan Beqaj: Mendoj që kjo pikë është shumë e rëndësishme, por duhej të ishte për tërë rrjetin e energjisë elektrike në Komunën e Shtimes. Kudo që të shkosh ka probleme me rrjetin elektrik. Në disa zona janë zënë edhe pjesë të asfaltit nga infrastruktura elektrike dhe nuk e di nëse ndonjëherë është dhënë arsyetim për këtë.

z.Muhamet Ademaj: Mendoj se kërkesat e fshatit Pjetërshticë janë të drejta. Edhe ne në lagjen Ademaj kemi të njëjtin problem, por edhe fshatra të tjera përballen me mungesë të energjisë elektrike. Kam bërë kërkesë në KEDS, por përgjigjet kanë qenë shumë negative. Ka ardhur koha që të bëhemi bashkë dhe të nxjerrim një rezolutë të përbashkët që Komuna e Shtimes të furnizohet me energji elektrike 24 orë dhe të ndërrohen shtyllat aty ku ka nevojë.

z.Besnik Seferi: Ky problem është në të gjitha fshatrat e Shtimes. Në KPF kemi vendosur që të nxjerrim një rekomandim. Megjithatë, kjo nuk është përgjegjësi e jona që ne të marrim vendime dhe ata t'i zbatojnë.

z.Faruk Beqa: Kemi pasur angazhime të vazhdueshme për t'i takuar përgjegjësit e KEDS-it. Me Kryetarin Aliu kemi arritur që dy herë t'i kemi në zyrë drejtorët kryesorë. Ata na kanë shpjeguar se për një periudhë të gjatë nuk kanë investuar në Shtime dhe se buxhetet e planifikuara janë orientuar diku tjetër. Kryetari Aliu ka pasur një takim të fundit me ta dhe tani janë duke punuar në Petrovë dhe vende të tjera. Një projekt ka kushtuar rreth 360 mijë euro dhe ka qenë afër dështimit. KEDS-i është treguar i papërgjegjshëm.

z.Shefqet Krasniqi: Ne jemi pjesë e këtyre qytetarëve. Qytetarëve të Pjetërshticës u themë se jam i gatshëm të përballem me këtë çështje dhe, nëse organizojnë protestë do të na kenë përkrash tyre.

znj.Erza Salija: Uroj që sa më shpejt të gjendet zgjidhje për banorët e Pjetërshticës. Megjithatë, duhet të ndërhyhet edhe në fshatra të tjera. Tensioni i ulët ka shkaktuar dëme në lagjen Hysenaj në Petrovë, në lagjen Qorrolli në Rashincë dhe në zona të tjera. Do të ishte mirë që këtyre zonave t'u sigurohet energji stabile, sepse qytetarët janë detyruar që çdo pajisje elektrike ta mbrojnë me stabilizatorë.

Nënkryetar, z.Adnan Ademi: Kjo kërkesë është shumë me vend. Për informim të qytetarëve të Komunës së Shtimes, dua të them se kemi pasur disa takime me KEDS-in. Takimi i fundit është mbajtur me drejtorin e KEDS-it dhe kemi diskutuar për këto probleme. KEDS-i e ka larguar edhe

kujdestarin nga Komuna e Shtimes dhe punëtorët që kanë qenë këtu tani punojnë në Lipjan. Edhe këtë e kemi kërkuar të rikthehet.

z.Shefqet Krasniqi: E dini pse po themi që duhet bërë trysni? Sepse në vitin 2016 është bërë një kërkesë për intervenim, duke filluar nga Pjetërshica e deri në vendet e tjera, por nuk ka pasur asnjë ndërhyrje dhe asnjë ndryshim.

z.Bajram Hajrizi: Kam edhe dy kërkesa nga qytetarët. Kur bëhet rregullimi i rrjetit në tokat bujqësore, po shkaktohen dëme dhe nuk po paguhet asgjë. E njëjta gjë po ndodh edhe në fshatrat Rancë, Topillë dhe Reçak. Po shkaktohen dëme dhe nuk po bëhet asnjë kompensim.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht vendosi që të përkrahë kërkesën e banorëve të fshatit Pjetërshicë lidhur me rrjetin e energjisë elektrike e cila do t'i dërgohet KEDS-it (Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike), si dhe të ftojë përfaqësuesin e KEDS-it (Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike) që të marrë pjesë në mbledhjen e radhës të Kuvendit, me qëllim që Kuvendit t'i jep sqarime, se pse nuk ka energji elektrike mjaftueshëm në të gjitha vendbanimet e Komunës së Shtimes.**

Pika 6

Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares së KPF-së znj.Yllkë Fejzullahu, me një anëtare të re (Pikë shtesë).

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Hapi diskutim për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Propozimi i parë ka qenë nga Demokracia për heqjen e pikës së rendit të ditës, ndërsa nga ne ka qenë propozimi për shtimin e pikës për Komitetin për Politikë dhe Financa. Do të ishte mirë të marrim një pauzë prej dy minutash për konsultim, sepse në fund duhet ta plotësojmë përbërjen e KPF-së.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Në rregull atëherë e hedhim në votim propozimin për shtyrje në kësaj pike.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht vendosi që pika e rendit të ditës me numër 6, “Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politikë dhe Financa znj.Yllkë Fejzullahu me një anëtare të re” të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit.**

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Pasi nuk ka diskutime të tjera, e përfundoj këtë mbledhje në orën 16:21.

Procesmbajtëse
Sadberë Halili



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

